



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.14, datë 16.01.2023

PËR  
“CAKTIM TË PËRKOHSHËM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Moisi Duda, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Zoti Moisi Duda do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, nga data 24.01.2023 deri më 31.01.2023.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Moisi Duda do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Moisi Duda, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Elaida Coxhi

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Bujan Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Arta Mandro

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Sciti

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Ledina Riza